



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Raport Narrativ mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve të programit MSc në Fizioterapi 2026

Pikat e forta

Analiza e rezultateve të pyetësorit tregon se studentët kanë një perceptim pozitiv për cilësinë e programit MSc në Fizioterapi. Studentët vlerësojnë se programi u mundëson përvetësimin e njohurive dhe kompetencave të nevojshme profesionale dhe akademike, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Programi perceptohet si i orientuar drejt fizioterapisë së bazuar në evidencë dhe ofron njohuri multidisiplinare që mbështesin zhvillimin e kompetencave klinike dhe kërkimore. Studentët kanë vlerësuar pozitivisht organizimin e studimeve, përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse që lidhen me organizimin e mësimin, si dhe informimin lidhur me procedurat akademike dhe përgatitjen e temës së masterit.

Gjithashtu, rezultatet tregojnë se metodat e mësimdhënies konsiderohen të përshtatshme dhe interaktive, duke reflektuar angazhimin e stafit akademik për të krijuar një mjedis mësimor aktiv, bashkëpunues dhe të orientuar nga studenti. Kohëzgjatja e programit vlerësohet si e përshtatshme për arritjen e rezultateve të synuara të të nxëniet dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.

Fushat për përmirësim

Megjithëse rezultatet janë përgjithësisht pozitive, studentët kanë identifikuar disa fusha që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Këto përfshijnë përmirësimin e qasjes në informata përmes faqes zyrtare të Fakultetit dhe Universitetit, avancimin e infrastrukturës dhe pajisjeve për mësimdhënie dhe ushtrime praktike, si dhe përmirësimin e hapësirave të dedikuara për zhvillimin e aktiviteteve mësimore.

Një tjetër aspekt që kërkon vëmendje është zgjerimi i qasjes në literaturë bashkëkohore dhe databaza shkencore ndërkombëtare, me qëllim të mbështetjes së mëtejshme të praktikës së bazuar në evidencë dhe zhvillimit të kompetencave kërkimore të studentëve.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Masat e ndërmarra dhe veprimet për përmirësim

Programi MSc në Fizioterapi është i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe në vazhdimësi ndërmirrën masa konkrete për adresimin e rekomandimeve:

- Përditësimi dhe pasurimi i informatave në faqen zyrtare të Fakultetit dhe programit të studimit;
- Përmirësimi gradual i infrastrukturës dhe pajisjeve për mësimdhënie dhe ushtrime praktike;
- Rritja e qasjes në literaturë shkencore, databaza elektronike dhe burime digjitale të të nxënit;
- Integrimi i mëtejshëm i metodave inovative dhe teknologjive bashkëkohore në procesin mësimor;
- Vazhdimi i aktiviteteve të lidhura me praktikën e bazuar në evidencë dhe kërkimin shkencor;

Përfundim

Rezultatet e pyetësorit konfirmojnë se programi MSc në Fizioterapi ofron një përvojë akademike cilësore dhe kontribuon në zhvillimin e kompetencave profesionale, klinike dhe kërkimore të studentëve. Në të njëjtën kohë, programi mbetet i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, duke adresuar rekomandimet e studentëve dhe duke siguruar përputhshmëri me standardet institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.